



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 55

Prishtinë, më 11.03.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Armend Zemaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Avni Uka-BOTA SOT; Driton Vitia-KOSOVA SOT; Valon Qyqalla-RROKUM TV; Arton Demhasaj-ÇOHU; Dren Ajeti-GLSP; Dhurata Kryeziu-OSBE; Sanije Berisha; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Dukagjin Maliqi-RTV DUKAGJINI; Sahadete Zogaj- KOSOVA PRESS; Florina Ujupi- BIRN; Gentiana Azemi- PRAKTIKANTE; Fjolla Uka- KDI; Ridvan Slivova-TELEGRAFI dhe Arta Rexha-RROKUM TV.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9,19,23 dhe 26 shkurt 2016;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-064 për Patentë shofer;
5. Formimi i grupit punues dhe caktimi i datës për mbajtjen e dëgjimit publik për Projektligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;

6. Formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe të ligjit nr. 04/L-141 për provimin e jurisprudencës;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë shtesë si vijon;

- Diskutim për Projektligjin e Kuvendit dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9,19,23 dhe 26 shkurt 2016

Kryesuesja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 9,19,23 dhe 26 shkurt 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kryesuesja duke iu referuar dispozitave të Ligjit 05/L-035 për Këshillin Prokurorial sqaroi për anëtarët e komisionit procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial nga ana e Kuvendit. Ajo më tej shtoi se deri në këtë moment në Kuvend kanë ardhur propozimet për tre kandidatë nga Fakulteti Juridik dhe një kandidat nga Kolegji Fama. Sipas saj, komisioni duhet të dërgojë tre emra në Kuvend dhe duhet të votohen në mënyrë të fshehtë me shumicën e votave të deputetëve.

Armend Zemaj e vlerësoi si në hap të rëndësishëm që komisioni për legjislacion ka bërë në funksionimin e pavarur të këtyre trupave, sidomos nga ndikimet politike, duke ju referuar Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Zemaj theksoi se me ndryshimet kushtetuese që janë bërë, Kuvendi gradualisht po shkarkohet nga përgjegjësia e emërimit të kandidatëve, sidomos në Këshillin Gjyqësor, dhe se tani ka mbetur pjesa e përzgjedhjes së kandidatëve nga Këshilli Prokurorial, emërime që sipas tij në të ardhmen të shkojnë nëpërmes Këshillit Prokurorial. Ndërsa sa i përket propozimeve, Zemaj kërkoi kujdes nga ana e komisionit që të mos vije puna të atakohemi se në Kuvend po bëhen emërime politike, duke theksuar se Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kuvendi dhe komisioni duhet t'ia ofrojë një emër i cili nuk është i atakuar nga ndikimet politike.

Agim Aliu - Tha se në kuadër të punës, si komision, është punuar shumë që të përgatitet legjislacioni i duhur që do të siguronte edhe në Këshillin Gjyqësor dhe atë prokurorial një pavarësi në mënyrë që këto organe shume të rëndësishme të jenë në rrugë të duhur dhe në harmoni me kërkesat e qytetarëve. Deputeti Aliu përmendi se përkundër vështirësive që ka pasur komisioni, prapë ka arritur të krijohet një paanësi dhe pavarësi e këtyre dy institucioneve. Ndërsa sa i përket propozimeve, z. Aliu tha se meqë janë në pritje edhe të propozimeve nga Oda e

Avokateve dhe shoqëria civile, ai rekomandoi që, si komision, të përcaktohen për dy emra sot, por të mos procedohen këta emra në Kuvend pa u plotësuar e gjithë dosja.

Armend Zemaj – Në lidhje me propozimet e bëra nga fakultetet juridike tha se si komision mund të procedojmë me tre emra, por ai kërkoi që t'i bëhet ftesë Këshillit Prokurorial dhe t'i kërkohet të dërgojnë edhe emra të tjerë, nga Oda e Avokateve dhe shoqëria civile, në mënyrë që Kuvendi të mos ngarkohet tri herë me votime të fshehta, që pasi të kompletohen këta emra, tha se mund të dërgohen listat në seancë plenare.

Kryesuesja – Duke marrë parasysh propozimin e disa nga parafolësve që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe të kërkohet nga Këshilli Prokurorial plotësimin emrave edhe me propozimet nga shoqëria civile dhe Oda e Avokatëve, në mënyrë që të dërgohen në seancë të kompletuara dhe meqë nuk kishte diskutime të tjera.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime vendosi që pika tre e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial, të shtyhet për një mbledhje të radhës.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-064 për Patentë shofer

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Armend Zemaj- Tha se vërejtjet e tij janë në amendamentet: 17, 20, 22, 25, 28, 29, 30, 36, 45, 49,50,92,94 dhe 95.

Në amendamentin 17, Zemaj kërkoi të hiqen fjalët: “në të holla”, pasi që formulimi aktual është joadekuat, ngase sipas tij rregullativa aktuale ligjore nuk njeh këtë si formulim, kur dihet që gjoba paguhet në të holla dhe nuk ka nevojë të thuhet: “me gjobë në të holla. Më pas ai vlerësoi se në amendamentet: 20, 22, 25, 28, 29, 30, 36, 45, 49, 50, 92, 94 dhe 95 fjalët: “*të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për veprë penale, vrasje, sulm fizik, sulm të integritetit seksual apo për shkak të rrezikimit të sigurisë në trafikun rrugor*”, duhet të hiqen dhe të riformulohen si vijon: “Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale”, ose “Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, më shumë se 6 muaj burgim.

Zemaj tha se përfshirja e vetëm një numri të caktuar të veprave penale, si kriter për udhëheqësin profesional të auto-shkollës apo për licencim për instruktor, është standard jo i mirë dhe është në kundërshtim me Kushtetutën që proklamon barazinë para ligjit. Sipas tij, nuk mundet që me ligj të veçantë (special), të ketë ndarje të veprave penale, kryerja e të cilave të ndalon apo të lejon ushtrimin e një autorizimi ligjor, që i bie që për të gjitha veprat e tjera penale mund të ushtrosh autorizime sipas këtij ligji, përveç për veprë penale vrasje, sulm fizik, sulm të integritetit seksual apo për shkak të rrezikimit të sigurisë në trafikun rrugor.

Deputeti Zemaj në vazhdim iu referua edhe kodit penal të Republikës së Kosovës, duke theksuar se ky kod parasheh një mori të veprave penale, që mund të jenë edhe më të rënda se ato që

përmendën në këto përkufizime. Kjo vërejtje, sipas tij, vlen edhe për dispozitat e projektligjit, ku thuhet: “në tri vitet e fundit nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale”, dhe ky formulim nuk bën të mbetet, dhe kërkoi të riformulohet sipas rekomandimit të dhënë. Në fund z. Zemaj propozoi të rikthehet projektligji ose në të kundërtën në seancë plenare të paraqiten në formë të amendamenteve.

Doruntinë Maloku paraqiti vërejtjet e saja në lidhje me amendamentin e katër i cili thotë se “patentë shoferi ndërkombëtar, dokument identiteti i të cilit mundëson mbajtësin të drejtë automjetin jashtë shtetit që lëshon këtë dokument”, duke potencuar se sipas këtij përkufizimi patentë shoferi që lëshohet në vendin tonë nuk mund të përdoret edhe jashtë shtetit tonë dhe kjo sipas saj bie ndesh me ligjin, duke kërkuar që ky amendament të riformulohet.

Kryesuesja në fjalën e saj theksoi se është e pranueshme të vlerësohet masa e dënimit gjashtë muaj apo një vit, por e vlerësoi si të pa pranueshme që të bëhet klasifikimi i veprave penale, sepse sipas saj vepra penale është vepër penale dhe nuk duhet të lejohet që ky projektligj të miratohet në këtë formë. Më pas ajo tha se pajtohet që ky raport me rekomandime t’i kthehet Komisionit FunkSIONAL dhe nëse ata nuk i marrin parasysh rekomandimet, atëherë ne, si komision, duhet që në Kuvend të jemi më të zëshëm në mënyrë që ligjet të mos miratohen me gabime sepse do të ketë problem në implementim, përfundoi kryesuesja Halimi.

Armend Zemaj - Tha se rregullorja përcakton Komisionet FunkSIONALE dhe të përhershme dhe për këtë arsye duhet të ketë kujdes që ligjet të jenë në harmoni me ligjet që janë në fuqi dhe me Kushtetutën e vendit. Sipas Zemaj Komisioni FunkSIONAL është i obliguar që rekomandimet të cilat i shkojnë nga komisioni për legjislacionin t’i shqyrtojë, pasi që janë obliguese sidomos në pjesën ligjore.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë;

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-064 për Patentë shofer dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, përveç amendamenteve: 4, 17, 20, 22, 25, 28, 29, 30, 36, 45, 49, 50, 92, 94 dhe 95 dhe dispozitat e projektligjit, që këto amendamente u referohen.
2. Rekomandohet që amendamenti 4 të hiqet apo riformulohet.
3. Rekomandohet që në amendamentin 17, të hiqen fjalët “në të holla”.
4. Rekomandohet që në amendamentet: 20, 22, 25, 28, 29, 30, 36, 45, 49, 50, 92, 94 dhe 95 fjalët: “të mos ketë qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale, vrasje, sulm fizik, sulm të integritetit seksual apo për shkak të rrezikimit të sigurisë në trafikun rrugor”, të hiqen dhe të riformulohen si vijon;

“Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale”, ose “Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, më shumë se 6 muaj burgim”.

5. Formimi i grupit punues dhe caktimi i datës për mbajtjen e dëgjimit publik për Projektligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;

Kryesuesja konstatoi se komisioni për shqyrtimin e projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje formoi grupin punues në përbërje;

- Armend Zemaj-kryesues,
- Agim Aliu-anëtar,
- Milena Miliçeviç-anëtare,
- Danush Ademi-anëtar.

Në vijim, gjithashtu u vendos që më 21.03.2016 të organizohet Dëgjimi publik për Projektligjin për Kundërvajtje.

6. Formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe të ligjit nr. 04/L-141 për provimin e jurisprudencës

Kryesuesja konstatoi se komisioni formoi grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, në përbërje si vijon;

- Agim Ademaj-kryesues,
- Selvije Halimi-anëtare,
- Doruntina Maloku-anëtare, dhe
- Danush Ademi-anëtar.

Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.04/L-141 për provimin e jurisprudencës formoi grupin punues në përbërje si vijon;

- Nezir Çoçaj-kryesues,
- Selvije Halimi-anëtare,
- Armend Zemaj-anëtar, dhe
- Milena Miliçeviç-anëtare.

7. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi anëtarët e komisionit se në këtë pikë (të ndryshme) do të diskutohet për Projektligjin për Kuvendin dhe rregulloren e punës së Kuvendit, dhe meqë Armend Zemaj është kryesues i Nënkomisionit për Mandate dhe Imunitete, kryesuesja i jep fjalën që të raportojë në lidhje me takimin që është mbajtur me përfaqësuesit e projektit të binjakëzimit në lidhje me këtë projektligj.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se projektligji për Kuvendin është i përfunduar dhe gjithashtu i është dërguar qeverisë të jap mendimin e saj, edhe pse sipas tij, në shumë pika nuk janë pajtuar.

Ai theksoi se komisioni ka punuar që të bëjë një ligj i cili siguron pavarësinë funksionale edhe të Kuvendit, si organi më i lartë legjislativ, dhe në këtë Zemaj tha se edhe projekti i binjakëzimit i financuar nga Komisioni Evropian ka mbështetur draftin e parë, të cilët sipas tij kanë dilemat e tyre në ndryshimet që ka bërë Komisioni Funksional. Në fund, Zemaj propozoi që të organizohet një punëtori, ku do të diskutohet për ligjin dhe rregulloren e Kuvendit.

Kryesuesja - Propozoi që, si komision, të merret një vendim që të mos kthehet puna në pikën zero me këtë ligj, por të vazhdohet puna aty ku ka mbetur. Ajo kërkoi të bisedohet me Kryesinë e Kuvendit dhe të kërkohet nga ministrat përkatës të qeverisë, ministrin e Financave dhe ministrin e Administratës Publike, që të sqarohen aty ku preket puna e tyre në këtë ligj.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë,

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Nënkomisioni për Mandate, Imunitete, dhe Rregulloren e Kuvendit, të vazhdohet me punën rreth hartimit të Projektligjit për Kuvendin sipas rekomandimeve të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E hartoi;
Mirlinda Kolgeci

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi